

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

22.01.2021

Ora 10:30

RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin e Kërkesës Ankimore nr.1 “Ndryshimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 7, datë 14.01.2021” me ankues, Lëvizja Socialiste për Integrim” dhe Kërkesës Ankimore nr.2 Ndryshimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 7, datë 14.01.2021” me ankues, z. Arben Qalliu, Titullar i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

PJESËMARRJA :

KQZ:

KAS:

Z.Elvin LAKO

Z.Elvis ÇEFA

Z.Illirjan RUSMALI

Z.Koli BELE

Z.Ledio BRAHO

Stafi KQZ: Y.Merkaj, E.Meta, Olsi Peto

Parti politike: Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI

Z.Kreshnik Kolndreu, përfaqësues ligjor i LSI

Z.Ervin Zoto, përfaqësues ligjor i z.Arben Qalliu

Z.I.Rusmali: Mirdita të gjithëve çelim seancën e planifikur për sot në orën 10:30, Në këtë seancë janë të pranishëm ankuesit, ju lutem prezantohuni me mikrofon.

Z.Ervin Zoto, përfaqësues ligjor i z.Arben Qalliu: Për ankuesin Arben Qalliu i pranishëm avokati Ervin Zoto, sipas prokurës së posaçme të dorëzuar në seancën e kaluar.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

Z.I.Rusmali: Po Faleminderit

Z.A.Kaziaj, përfaqësues LSI-së: Altin Kaziaj, përfaqësues i LSI-së!

Z.K.Kolndreu përfaqësues ligjor i LSI-së:

Z.I.Rusmali: Po jeni të dypër të njejtin subjekt po, faleminderit prezent është administrata e KQZ-ve sic ishte kërkuara nga ana jonë, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe ekipi i tij. Zoti Sekretar i Përgjithshëm kërkesa për palët e interesuara nuk ka.

Z.Y.Merkaj: Jo nuk ka deri tani asnjë kërkesë.

Z.I.Rusmali: Mirë nuk kemi nevojë të kalojmë në procedurë verifikim legjitimimi për palët e interesuara sepse mungojnë as për të marrë vendim për pranimit të palëve të interesuara. Deklarimet për konflikt interesi nga anëtarët e kasit nuk ka. Kërkesa për konflikt interesi nga palët?

Z.A.Kaziaj, përfaqësues LSI-së: Nuk kemi i nderuar.

Z.I.Rusmali: Faleminderit, nuk ka ok kërkesa për moskompetencë ose për tejkalim të afatit të ankimit?

Z.A.Kaziaj, përfaqësues LSI-së: Nuk kemi.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

Z.I.Rusmali: Nuk ka, mirë atëherë do të doja nga Sekretari Përgjithshëm ju lutëm shkurtimisht na prezantoni çështjen që i është paraqitur KQZ-së përpara se t'ia jap fjalën ankuesve.

Z.Y.Merkaj: Atëherë në KQZ-ve në datën 30.12.2020 janë raportuar dy denoncime nga subjekti politik Lëvizja Socialiste për integrim ku dhe faqen aktivitete të ndaluara në rubrikën Kallzo për veprimtaritë e deputetit të Partisë Socialiste Qarku Fier zotit Bujar çela i cili ka publikuar në llogarinë e tij personale në fb disa foto me qytetarë të ndryshëm duke shpërndarë Leje Legalizimi në shtëpitë e tyre, në njësinë administrative Hysë Gjokaj. Denoncimet janë regjistruar në këtë faqe në datën 30 dhjetor 2020 ora 19:18 dhe 19:39. Me të marrë denoncimin Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar parapraksht mbi kërkesën lidhur me kompetencën e tij për shqyrtimin e kësaj çështje dhe në vijim të procedurës administrative për shqyrtimin e denoncimit të paraqitur nga subjekti Politik Lëvizja Socialiste per Integrim. Për sa më sipër denoncuesi ka kërkuar shqyrtimin e rastit konkret dhe marrjen e masave sipas përcaktimit të vendimit nr.9 2020 të Komisionit Rregullator pasi pretendon se janë shkelur nenet e përcaktura në këtë vendim. Në datën 11.01.2021 ora 12:00 Komision Shtetëror i Zgjedhjeve ka zhvilluar seancën dëgjimore në përputhje me përcaktimin e nenit 47 dhe 37 të kodit të Procedurës Administrative me zotin Arben Qalliu. Pasi ka shqyrtuar këtë procedurë administrative, në fund Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve ka vlersuar se veprimet e zotit Arben Qalliu kanë shkelur nenin 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhorë si dhe të vendimit nr 9 të vitit 2020 të Komisionit Rregullatorë të dalë në bazë dhe për zbatim të Kodit Zgjedhorë. Në përfundim të procedurës administrative Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur të dëndojë me gjobë zotin Arben Qalliu me detyrën drejtor i drejtorisë vendore Lushnje. Në agjensinë shtetërore të

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

Kadastrës me shumën 1500 lekë për shkelje të ligjit në numrin 10019 të Kodit Zgjedhorë i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar. Kundër këtij vendim kanë bërë ankim si zoti Arben Qalliu i cili është dënuar me gjobë dhe subjekti politik kallzuesi, Lëvizja Socialiste për Integrim pasi nuk janë dakort me vendimin e dhënë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Në këto kushte të dyja ankesat kanë kaluar për shqyrtim në kopetencë të KAS, faleminderit.

Z.I.Rusmali: Faleminderit zoti Sekretari i Përgjithshëm, administrata e KQZ-së i ka vënë KAS-it në dispozicion dosjen e plotë administrative që ka administruar deri tani, unë do kërkoja fillimisht nga avokati i zotit Qalliu të prezantojë kërkesën e tijë drejtuar nesh.

Z.Ervin Zoto, përfaqësues ligjor i z.Arben Qalliu: Po të nderuar anëtarë dhe pjesëmarrës në këtë seancë ne kemi kundërshtuar vendimin nr.7- të në 14 janar 2021 të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilin është vendosur ky dënim me gjobë për zotin Arben Qalliu për arsye si të më poshtme. Si bazë ligjore për të dënuar ankuesin nga Komisioneri është relatuar neni 91 pika 1 dhe 92 i Kodit Zgjedhorë si dhe neni 3 pika 2 i vendimit nr.9 të Këshillit të Komisionit Rregullator. Lidhur me nenin 91 janë të ndara momentet pra në pikën e parë flitet për momentn e zgjedhjeve, në pikën 3 flitet për fushatën zgjedhore dhe në pikën 4 flitete për afatin 4 mujorë para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qevirisë së rë. Pra e vetmja pikë ku ne mund të marrim shqyrtim për nenin 91 është pika 4 e cila lidhet me aktet ligjore nënligjore të cilat nuk mund ti nxjerri ankuesi por edhe vetë Komisioneri nuk e ka shënuar si bazë ligjore pikën 4. Po të kalojmë te neni 92 i Kodit Zgjedhorë, në të parashikohet se instituconet publike, qendrore vendore si dhe njesitë e tjera nuk po i lexoj të tëra raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

me karakter publik që planifikohen dhe zhvillohen në perjudhen 4 mujore para datës së zgjedhjes deri ditën e zgjedhjeve. Më tej ky nen thotë formajnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesmarrjen e publikut apo të medias si dhe ato që kanë të bëjnë me agjentët e informimit etj. Në vërtetim të këtij neni del se ankuesi zoti Arben Qalliu nuk mund të dënohet për këtë shkelje për të cilën është dënuar pasi nuk ka zhvilluar asnjë veprimtari me karakter publik . Madje dhe në fotot e deputetit që ka postuar në llogarinë e tij personale në rrjetin social fb, nuk janë bërë gjatë zhvillimit të ndonjë aktiviteti për veprimtari me karakter publik pasi nuk mund të quhen të hapura për publikun nëpërmjet medias në ambjentet brenda rrethimit të banesave të cilat është bërë nga një foto me pjestarët e atyre familjeve që banonin në to, pa prani publiku apo mediash. Por edhe sikur të ishte ashtu pra të ishte bërë në ndonjë ambjent publik kuptohet qartë që fotot janë bërë kohë më parë dhe në kohra të ndryshme pasi është e pamundur që një deputet të jetë i pranishëm në të njejtin moment në tetë familje të ndryshme të postojë fotot ekzaktësisht në momentin që janë bërë. Pasi në të njejtin postim janë tetë ambjente të ndryshme që ka publikuar. Të gjitha ato foto janë bërë siç ju thashë janë bërë në ambjente të ndryshme të nëri tjetrit brenda rrethimeve të banesave përkatëse të secilit qytetarë dhe nuk kanë qenë në aktivitete të hapura për pjesmarrjen publike apo mediash. Për më tepër që ankuesi Arben Qalliu nuk shfaqet në asnjërën prej fotove pasi nuk ka qenë i pranishëm atje. Po në të njejtën logjikë ligjore me Kodin Zgjedhorë është formular edhe vendimi nr.9 i vitit 2020 i Komisionit Rregullator ku kërkon që veprimtaritë janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të mediave në lidhje me afatin katër mujorë që po diskutonim. Pra të nderuar dhe nga ky vendim parashikohet ndalimi për planin e veprimeve të caktuara për në perjudhën 4 mujore të zgjedhjeve me specifikimin se duhet që këto aktivitet të jenë me pjesmarrje të publikut edhe të medias. Për këtë arsye në

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

momentin kur nuk ekziston një veprimtari me karakter publik komisioneri nuk duhet ti vazhdojë më tej procedurat verifikuese por duhet të rrëxonte denoncimin e paraqitur në ngarkim të zotit Arben Qalliu. Po ashtu nga të gjitha rrethanat dhe provat del e qartë se dorëzimi i këtyre lejeve është bërë nëpërmjet punonjësve të terrenit Lushnje. Kundrejt procesverbaleve përkatëse me nënshkrimet e subjekteve përfitues të lejeve dhe nuk mund të aludohet si të jetë leja i janë dhënë deputetit dhe është e drejta e banorëve që bëjnë foto me këdo duke ekspozuar në foto qoftë dokumenta të ndryshme përfshirë edhe Lejen e Legalizimit apo kapitaleve të tjera apo sende që ata posedojnë. Gjithashtu në paragrafin e fundit të faqes 7 të vendimit komisioneri bën interpretimin e nenit 10 pika 5 të ligjit 111 2018 për Kadastrën. Në të cilin parashikohet drejtori i drejtorisë vendore është autoritet që lëshon akte kadastrale për çdo pasuri që gjendet në juridiksionin territorial të drejtorisë dhe nxjerr aktet në zbatim të ligjislacionit për çështjet dhe pronësisë. Pra në këtë moment komisioneri njëson shpërndarjen apo dorëzimin e lejes së legalizimit me shprehjen lëshon akte kadastrale, bëhet fjalë që lëshon akte kadastrale ka kuptimin edhe në sformën e vlerës sipas ligjit të akteve që lëshon provon ASHK. Si hallkë e fundit që nënshkruhet nga drejtori dhe vuloset më tej dokumenti. Ndërsa shpërndarja apo dorëzimi është një proces jetër të cilin nuk mund ta bëjë kurrsesi personalisht drejtori. Dorëzimi mund të bëhet në forma të tjera si duke e dorëzuar me postë ose duke ja dorëzuar këtë personalisht subjektit. Pretendimi i komisionerit se dorëzimi duhet bërë vetëm nëpërmjet sportelit nuk është i bazuar pasi në VKM që përmendëm më sipër 954 të vitit 2015 së cilës komisioneri i referohet përdoret vetëm termi i dorëzimit subjektet përfitues por nuk specifikon nëse dorëzimi bëhet vetëm në sportele apo siç bëhet në situatën aktuale për shkak të pandemisë, nga grupi i terrenit cili shkon për të bërë matjet që në të njëjtën kohë shfrytëzon edhe për të dorëzuar çertifikatat. Po ashtu duhet theksuar se shpërndarjet

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

e lejeve të cilat janë prodhuar në muajin nëntor 2020 është bërë me datë 09.12.2020 pra shumë ditë përpara se të vinte afati 4 mujorë përpara datës së zgjedhjeve dhe rrjedhimisht nuk mund të penalizohet nëse vonesa është normale për shkeljet e pretenduara. Po ashtu në faqen 9 të vendimit funksionari ka vlersuar se zoti Arben Qalliu duke lejuar dorëzimin e dokumentave në ambjentet familjare dhe jo në sportelet e dedikuara ose nëpërmjet postës është në kundërshtim me VKM që përmendëm më sipër në nenin 954 edhe ky pretendim është i pa bazuar në ligj pasi për shkak të pandemisë në të gjitha institucionet që përmendëm nuk duhet të lejojnë krijimin e rradhës nëpër sportele me urdhrin e drejtorit për dorëzimin e tyre në familje është tagër i tij sipas nenin 10 pika 5 e ligjit për kadastrën. Siç e thamë ku në parashikimet e tjera ku nxjerr dhe aktin në zbatim të legjislacionit për çështjen e pronësisë. Por edhe sikur të supozojmë që ai urdhër të ishte i pa bazuar në ligjë, kjo nuk do të thotë se ankusi ka kryer shkelja të ligjeve zgjedhore për më tepër edhe data e urdhërit që pretendohet se nuk është në disfraksion të drejtorit të datës 09.12.2020. Pra nuk përfshihet në periudhën 4-mujore që po diskutojmë. Për këtë arsye u jemi drejtuar më këtë ankim. Kërkojmë pranimitë të tij dhe ndryshimin e vendimit nr.7, dt.14.01.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke e deklaruar atë vendim si të pabazuar në prova dhe në ligj dhe heqjen e dënimit me gjobë për zotin Arben Qalliu në detyrë Drejtor i Drejtorisë Vendrore Lushnje në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, faleminderit!

Z.I.Rusmali: Faleminderit për shpjegimet, përpara se të kalojmë tek ankuesi tjetër, ndoshta është mirë që të bëjmë dy-tre pyetje për sqarim rreth shpjegimeve.

Z.Ervin Zoto, përfaqësues ligjor i z.Arben Qalliu: Po i nderuar!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

Z.I.Rusmali: Në dijeninë tuaj, ju jeni avokati nuk jeni ankuesi, në dijeninë tuaj ankuesi ka njohje, ka komunikim me deputetin në marrëdhënie rutinë pune, pavarësisht nga kjo ngjarje, apo jo?

Z.Ervin Zoto, përfaqësues ligjor i z.Arben Qalliu: Në dijeninë time nuk kanë asnjë lloj kontakti, nuk ka njohje me të.

Z.I.Rusmali: Në dijeninë tuaj, mbasi ka marrë vesh për denoncimin, ankuesi ka komunikuar me specialistët e vet për të marrë informacion rreth ngjarjes?

Z.Ervin Zoto, përfaqësues ligjor i z.Arben Qalliu: Nuk e di, nuk e kam pyetur për këtë, por me siguri që duhet të ketë komunikuar, vetë fakti që u bë mediatik dhe filloi hetimi administrativ.

Z.I.Rusmali: Mu duk sikur ju thatë “që fotot që janë postuar në facebook i përkasin periudhës nëntor 2020..

Z.Ervin Zoto, përfaqësues ligjor i z.Arben Qalliu: Jo, jo thashë që lejet e legalizimeve me të cilat janë bërë fotot janë prodhuar në nëntor.

Z.I.Rusmali: Keni dijeni fotot në cilën periudhë janë bërë? Sepse thatë që nuk janë në të njejtën kohë me postimin?

Z.Ervin Zoto, përfaqësues ligjor i z.Arben Qalliu: Po pra, nuk mund ta marrim të mirëqenë.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

Z.I.Rusmali: Nuk keni info?

Z.Ervin Zoto, përfaqësues ligjor i z.Arben Qalliu: Jo, nuk kam informacion, por thjesht me deduksion del që është e pamundur të jenë bërë në atë moment dhe të postohen në tenda të ndryshme..

Z.I.Rusmali: Qartë, qartë! Ndonjë pyetje?

Z.L.Braho: Keni informacion se përse nuk janë dërguar me shërbim postar lejet e legalizimit siç e përcakton dhe baza ligjore. Pra, ose aplikimi do të bëhet nëpërmjet sportelit, ose nëpërmjet shërbimit postar. Ndërkohë që nuk është përdurur asnjë nga këto alternativa. Ka ndonjë arsye specifike?

Z.Ervin Zoto, përfaqësues ligjor i z.Arben Qalliu: Doja të sqaroja se baza ligjore, ose ligji më saktë e detyron që ose ta nisë nëpërmjet shërbimit postar, ose thotë vetëm shprehjen “i dorëzon subjektit përfitues”. Pra, në asnjë moment nuk përcaktohet ku do bëhet dorëzimi, do të bëhet pranë banesës duke qenë se dhe pandemia i ka orientuar të gjithë sportelet që të kenë sa më pak rradhë, apo do të dorëzohet në sportel. Nuk është asnjë hap i përcaktuar si detyrim që duhet të dorëzohen vetëm pranë sporteleve. Për sa kohë drejtori është përgjegjës për të rregulluar dhe menaxhuar në funksion të mirëfunksionimit të punëve është e drejtë e tij dhe urdhëri që ka nxjerrë për të bërë shpërndarjen nga grupet e terrenit.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Ankimeve dhe Sanksioneve.
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

Z.E.Zoto, përfaqësues ligjor i z. Arben Qalliu : Pra, me shprehjen popullore një rrugë e dy punë!

Z.I.Rusmaili: Në rregull! Ndonjë pyetje tjetër, nga kolegët? Po zoti Bele?


Z.K.Bele: Në dijenin tuaj, përveç rasteve të administruara sipas urdhërit numër 30/66 të datës 09.12.2020. Lidhur me shpërndarjen e certifikatave nga tre specialistët në Golem, Karbunarë edhe Hysgjokaj Lushnje. A ka raste të ngjashme, pra për të na ndihmuar të kuptojmë është praktikë e normuar ose praktikë që ndodh tipikisht në këtë degë, të Kadastratës Lushnje, apo është vetëm ky rast? Nëse keni dijeni?

Z.E.Zoto, përfaqësues ligjor i z. Arben Qalliu : Nuk kam informacion lidhur me drejtoritë e tjera vendore dhe të ASHK-së por për shkak të rasteve që ka pasur ASHK Lushnje me staf, me personel të infektuar është parë më e arsyeshme që mos të kishte grumbullime në ato sportele. Nuk di në lidhje me raste të mëparshme apo të më passhme pasi jam fokuar në këtë mbrotje që po bëj pikërisht në periudhën që ne po diskutojmë. Periudha 4 mujore përpara datës së caktuar për mbatjen e zgjedhjeve. Faleminderit!

Z.K.Bele: Faleminderit!

Z.I.Rusmaili: Pyetje të tjera? Nuk ka! Kalojmë tek subjekti tjetër tek ankuesi tjetër? Do e merrni fjalën ju, kolegu pastaj mund të shtojë, mund të plotësoj.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Ankimeve dhe Sanksioneve.
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

Z.A. Kaziaj përfaqësues i LSI: Së pari duke qenë se është seanca e parë e këtij komisioni iu uroj një detyrë sa më të lehtë dhe të mbarë në këtë funksion të lartë shtetëror të gjithë anëtarëve. Për sa i përket pjesës së relatimit tim lidhur me kërkesën ankimore të depozituar brenda afateve ligjore prej 3 ditësh parashikuar kjo në rregulloren përkatëse, miratuar me nenin 3 datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator. Nga sa tha përfaqësuesi i shtetasit Qalliu, dalin qartë element të bashkëpunimit të themi, pavarësisht se ai tha se nuk ka njohje midis përfaqësuesi të ASHK-së ose drejtorit të saj rajonal të qytetit të Lushnjës, dhe ligjvënësit Çela. Është e pa pranueshme qoftë edhe në aspektin të themi funksional të funksionit që ka një deputet që bërja publike e disa dokumenteve shtetëror të cilat kanë një procedurë të mirëpërcaktuar për marrjen e tyre, keq orienton njerzit, krijon avantazhe të pamërituara tek një subjekt politik, dhe nuk ka sesi të mos jetë përgjegjës për këtë veprimtari të tijën, të bërë publike në faqen e tij zyrtare në Facebook, thënë këtë i nderuar zoti relator i kësaj çështje, të nderuar anëtarë të komisionit, së pari duhet të bëjmë dy ndarje për sa i përket pjesës së vendimarrjes së Komisionit Rregullator me vendimin numër 9 datë 24.12.2020 që i përkasin nenit 3 të tij. Ku parashikohet: “veprimtari që nuk lejohen të mbështeten dhe të promovohen që janë të listuara në pikën 1/1 dhe veprimtari krejtësisht të ndaluara që janë të listuara në pikën 1/3 të nenit 3”. Pra, duhet bërë kjo ndarje para se komisioni të marrë një vendimarrje të themi të bazuar mbi provat, dhe mbi shkeljet ligjore të pretenduara nga ana jonë në këtë rast. Sqarojmë KAS-in se diferencat midis dy kategorive dhe veprimtarive të përcaktuara në pikën 1/1 dhe 1/3 të nenit 3 të vendimit nr.9 të vitit 2020. Është pikërisht fakti se për veprimtaritë të listuara në pikën 1/1 institucioni përgjegjës raporton pranë KQZ-së për veprimtarinë publike që duhet të kërkojë. Ndërsa për veprimtaritë e parashikuara në pikën 1/3 të nenit 3 të vendimit të Komisionit Rregullator nr.9 të vitit 2020.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Ankimeve dhe Sanksioneve.
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

Sqaron faktin se ato janë automatikisht të ndaluara dhe nuk ka se si të marri leje dikush për kryerjen e këtyre veprimtarive. Pra, në këtë rast kemi një veprimtari të ndaluar të bërë nga bashkëpunimi i një ligjvënësi me një drejtor rajonal i cili detyrën funksionale e ka nëpërmjet procedurave të përcaktuara të VKM-së përkatëse që specifikoi më parë kolegu. E ka për dhënien e këtyre lejeve të legalizimit nëpërmjet një shërbimi të themi të mirëpërcaktuar dhe jo nëpërmjet ndërmjetësit që në këtë rast është ligjvënës. Nga ana tjetër me vendimin nr.9 të vitit 2020 Komisioni Rregullator, shkeljet e listuara në pikën 1/3 lidhen automatikisht me zyrtarë të përcaktuar me pikën 2 të nenit 3 të vendimit. Pasi ne vlerësojmë dhe besojmë se edhe qëllimi i organit ligjvënës në KQZ në këtë rast Komisioni Rregullator këto kategori të ndaluara mund të kryhen jo vetëm nga zyrtarë të veshur me pushtet ekzekutiv, por praktikisht nga të gjithë ata persona që mund të kenë interes për kryerjen e tyre, nëpërmjet përfitimit fundor të themi, vënien në dispozicion të subjektit politik përkatës të disa privilegjeve të pa merituar. Pikërisht këtë qëllim ka pasur edhe ligjvënësi kur ka bërë ndryshimet përkatëse i nderuar në nenin 92 , 91, me ligjin 101 dhe 118 të vitit 2020. Pasi jemi njohur me vendimin e zbardhur të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.7.datë 14.01.2021, subjekti denoncues ka bërë pjesën procedurale të vet. Bazuar në nenin 124 pika 1 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 9 pika 8 të vendimit numër 3, datë 06.11.2020 kemi bërë ankim pranë këtij komisioni të nderuar. Të nderuar përfaqësues të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve! Së pari dua të them që këtë ankimin e kemi bërë për dy arsye të bazuara. Pikë së pari Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve e ka përjashtuar deputetin Çela si subjekt i cili nuk bën pjesë në rrethin e personave të përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 3 të vendimit nr.9 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator. Ky konstatim i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve evidentohet në fillim të vendimit numër 7 të tij në datë 14.01. 2020,

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Ankimeve dhe Sanksioneve.
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

e më tej në pjesën arsyetuese të këtij vendimi Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pavarësisht se ka konstatuar si veprimtari të ndaluara , shpërndarjen e lejeve të legalizimit nga deputeti Çela nuk e ka përfshirë dhe indentifikuar atë si person që kryen veprimtari të ndaluara duke iu referuar faktit se ai nuk bën pjesë në rrethin e personave të përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 3 të vendimit nr.9 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator. Me këtë vendim nuk jemi dakord pikë së pari sepse në nenin 3 pika 1/3 gërma a, të vendimit nr.9. të vitit 2020 Komisioni Rregullator parashikohet se: “ për veprimtaritë e ndaluara janë ato veprimtari që përfshijnë shpërndarjen dhe veprimtari publike të ,lejeve të legalizimit në periudhën 4 mujore, përpara datës së zgjedhjeve”. Në këtë rast përkon me datën 25 Dhjetor 2020. Perfaqësuesi i zotit Qalliu tha që janë lëshuar më përpara . Kush ka qenë pengesa që këto dokumenta shtetëror nuk kanë arritur të themi në përfituesin fundor që është qytetari, pse nuk kanë arritur në kohën e duhur dhe pse kanë arritur nëpërmjet dorës së deputetit?! Këto janë element të arsyeshem që bëjnë, krijojnë bindjen që deputeti i ka nëpërjet një lidhje të themi personale me përfaqësuesin e ASHK-së Lushnje, për përfitime personale të subjektit të tij ka mbajtur të themi duke mos dorëzuar në kohë dhe duke dorëzuar më vonë publikisht këto leje në mënyrë jo të përligjur të themi. Qëndrimi i KQZ-së po i referohem me shkurtim Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve përgënjeshtërohet nga vetë përmbatja vendimit numër 7 të vitit 2020 në pjesën kur referon po të shihni faqen 7 të vendimit i nderuar zoti relator i çështjes . Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se: “veprimtaria e zhvilluar nga deputetit zoti Bujar Çela , shpërndarja e lejeve të legalizimit në veprimtari publike përbën shkelje të parashikimeve të nenit 3 paragrafi i parë në paragrafin 1 pikë 3 gërma a të vendimit të Komisionit Rregullator numër 9 të vitit 2020”. Lidhur me arsyen e dytë, ajo ka të bëjë me masën e sanksionit dhe me bazën ligjore të cilën

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Ankimeve dhe Sanksioneve.
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë këtë vendimarrje. Të dyja këto masa nuk qendrojnë, edhe masat sanksionuese dhe pjesa e refermit të bazës ligjore mbi të cilën është mbështetur vendimarrja është krejtësisht e gabuar. Informoj komisionin se vendimi nr.7 i vitit 2020 në faqen 7 në lidhje me shkeljet konstaton se thuhet në vendim: “Jemi përpara faktit që një deputet ka shpërndarë leje legalizimi pra një dokument administrativ në kompetencë të ASHK Lushnje, dokument të cilat nuk prodhohen nga vetë ai. Lejet e legalizimit të shpërndara nga deputeti janë dokumenta të prodhuara në zotërim të drejtëpërdrejtë të Agjensisë Shtetërore të Kadastres, Drejtoria Vendore Lushnje nën juridiksionin e së cilës është edhe njësia administrative Hysgjokaj, pra njësia administrative ku publikisht shifet që janë shpërndarë këto leje legalizimi. Në këtë rast vazhdon Komisioneri duke qënë se lëshimi i akteve kadastrale, është në kompetencën drejtëpërdrejtë të Drejtorit të Drejtorisë vendore, përgjegjësia për shpërndarjen e këëtij dokumentacioni në veprimtari publike në njësinë administrative Hysgjokaj pjesë përbërëse e Bashkisë Lushnje i ngarkohet Drejtorit të Drejtorisë vendore zotit Qalliu. I cili me veprime apo mos veprime ka kontribuar në zhvillimin e këtij aktiviteti. Pra shihet qartë, përgjegjësia dhe bashkëpunimi midis dy personave pavarësisht se heqja e përgjegjësisë nga ana e deputetit është domethënë deri diku e pa mbështetur nga ana e komisionerit. Fakti publik që një deputet i një force politike që administron dokumentat e lëshuar nga ASHK Lushnje dëshmon se zoti Qalliu në veprimtarinë e tij ka toleruar qasjen e subjekteve politike, për të disponuar dokumentet të cilët janë në përgjegjësinë e tij të drejtëpërdrejtë dhe që duhet të ishin shpërndarë në sportel në shërbimet, ADISËS ose me postë, pra këto janë tre procedurat që duhen shpërndarë. Qasja vetë komisioneri në vendimin nr.7 në vitin 2021 përcakton faktin që qasja e një deputeti ka sjellë domethënë qasje të subjektit politik të cilin deputeti përfaqëson dhe kjo është krejtësisht veprimtari e

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Ankimeve dhe Sanksioneve.
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

ndaluar me nenet 3 dhe vijues të vendimit nr.9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Me veprimet e drejtëpërdrejta zoti Qalliu ka kontribuar indirekt që stafi në varësi të tij dhe dokumentet zyrtarë të lëshuara nga qytetarët të vihen në dispozicion të subjekteve politike për të ushtruar aktivitetet të ndaluara në kuptim të nenit 92.

Pra, klasifikimi i aktivitetit nuk është aktivitet për të cilin merret leje për zhvillimin e tij nëpërmjet ndërfaqes së përcaktuar në vendimin numër 9. Po ky është krejtësisht e ndaluar gjë që nuk mund të bëhet ta themi më shqip. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se veprimet e zotit Qalliu kanë shkelur nenin 91 dhe 92 të ligjit 10019 datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor i ndryshuar dhe vendimit të Komisionit Rregullator numër 9 të vitit 2020. Pra, i nderuar zoti Relator të nderuar anëtarë të KAS-it, ligjvësnit jemi përpara një ligji të miratuar me 3/5 dhe jemi përpara një vendimi të dalë, në zbatim të tij, për barazinë e armëve duke qenë se qeveria ose partia në pushtet ka të themi avantazhe në vetvete të krijuara në mënyrat e saj dhe mund të ushtrojë ndikim mbi punonjësit e saj për arritjen e qëllimeve të ndaluara nga ky vendim. Neni 10 i vendimit numër 9 i vitit 2020 përcakton se në rastet kur subjektet e parashikuar në pikën 4 të nenit 4 të këtij vendimi nuk raportojnë, raportojnë pjesërisht ose zhvillojnë veprimtari pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kur shkelja nuk përbën vepër penale, dënohet nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve me gjobë nga 3 mijë deri në 90 mijë lekë. Pra kjo duhet të ishte dispozita e përdorur se vetë relatori komisioneri në këtë rast në pjesën fundore, në pjesën e fundit të themi përpara se të japi vendimarrjen e vendimit numër 7 në datë 14.01.2021. Vetë raporton për këtë bazë ligjore dhe çuditërisht tek pjesa e dispozitivit kur thotë vendosi relatori që këto dispozita që kanë të bëjnë me aplikimin e nenit 171 pika 1 sipas komisionerit çuditërisht paskan të

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Ankimeve dhe Sanksioneve.
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

bëkan dhe qenkan shkelje të parashikuara në nenin 171 pika 2. Gjë që domethënë vetë vendimi i komisionerit bie ndesh me pjesën arsyetuese dhe me pjesën vendimarrëse po ta shohim. Lidhur me sa më sipër sqarojmë se pikat 1 dhe 2 të nenit 10 sanksionet administrative të vendimit nr.9 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator janë të listuara në sanksionet siç e thashë të lidhura drejtëpërsëdrejti me nenin 171 pika 1 dhe parashikon pika 2 e këtij neni 10 të vendimit nr.9 të vitit 2020 parashikon dhe sanksione të lidhura me nenin 169 bazë ligjore kjo jo e marrë parasysh nga komisioneri. Mesa duket ka qenë i keq orientuar. Përsa i përket pjesës siç e thashë të bazës ligjore besojmë se në rastin më të mirë ky duhet të jetë një lapsus i komisionerit duke qenë se është vendimi i parë dhënë për disa aktivitete të ndaluara shpresojmë që praktika të konsolidohet më vonë, dhe në rastin më të keq mund të jetë një lajthitje e momentit për shkak le të themi pjesës së ngarkesës së madhe të procesit që kemi në këto momente. Pasi siç e thashë më sipër konsiderohet veprimtari e ndaluar edhe në asnjë rast nuk duhet të ishte toleruar dhe duhet të ishte dhënë dhe moralisht le të themi jo vetëm ligjërisht një shëmbull konkret që qytetarët e këtij vendi të besojnë.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

Z.A.Kazijaj: Në këtë institucion të ngritur me ligj po bëhet drejtësi nga vendimarrja e një komisioneri që po zbaton disa akte të miratuara nga një Komision i posaçëm . Të nderuar anëtarë të Kasit për sa më sipër ju relatova vlerësojme se vendimi nr 7 18.01.2021 për zotin Qalliu është i pa mbështetur në dispozita ligjore po ashtu ju keni përpara gjithë dosjen e shqyrtuar nga komisioneri ku nuk janë gjetur elemente as në formë as në përmbajtje të pjesës justifikuese të zotit Qalliu ,veprime këto që vënë kundërshtim totalë me dispozitat ligjore të lartë përmendura ,të cilat e rëndojnë pozitën e tij dhe nëpërmjet bashkepunimit me ligjvënësin në vetvete .

Po ashtu vlerësojmë se vendimi numër 7 18.01.2021 për mosmarrjen në përgjegjësi administrative të zotit Çela dhe ky është i gabuar,Sa më sipër bazuar në nenin 30 pika 1 germa c të vendimit numër 30 .2020 të vendimit të Komisionit Regulator, përfundimisht i kërkojmë këtij komisioni ndryshimin e vendimit numër 7 18.01.2021 Komisioneri Shtetëror të Zgjedhjeve,faleminderit .

Z.Rusmali: Faleminderit, kolegu ka për të shtuar gjë?

Z.XXX: Faleminderit zotëri I nderuar ,jam dakord me kolegun.

Z.Rusmali: Vazhdojmë me një seancë pyetjesh të shkurtra ,

Pyetja e parë që kam unë dhe vlerëson të saktësohet,siç del nga denoncimi juaj, ju jeni nisur nga postimi në facebook i fotove të deputetit duke shpërndarë certifikata dhe mbi këtë bazë provuese keni bërë denoncimin?

Fakte rrethana apo prova të tjera përveç këtyre ju kanë rënë në dorë ndërkohë?

Z.A.Kazijaj: I nderuar zoti Rusmali ashtu siç parashikohet dhe në rregullat përkatëse për raportimin ndër faqe, barrën e provës për një denoncim të kësaj natyre e ka

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KOZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

subjekti që denoncohet, ne si barrë prove kemi vetëm denoncimin në vetvete për aq mundësi sa kemi për të bërë një gjë të tillë, ne kemi kontaktuar nga një rrrjetë social faqja zyrtare ose personale të ligjëvendësit Çela, të dali një listë personash dhe vizivisht është e shëmtuar ta themi por të dali një listë personash të një zone të caktuar të vendit tonë që këtyre personave deputeti po u jep dorazi një dokument ligjor që shumë qytetarë nuk kanë akses për ta marrë, është e shëmtuar për ta then por disa persona që deputeti pretendon se mund të jenë votues të tij arrikan qëllimin lehtësisht dhe shumë mirë që e arrijnë por jo në mënyrë të paligjshme dhe jo duke diskriminuar qytetarë të tjerë të këtij vendi dhe kjo është ajo që kemi bërë, kemi denoncuar faktin vetëm nëpërmjet bërjes publike të faktit nga vetë deputeti në faqen e vet zyrtare dhe Komisioneri Shtetëror normalisht kur ka menduar, në këtë rast ka aneksuar deputetin duke mos e marrë nën përgjegjësi administrative por I ka kërkuar materiale provuese zotit Qalliu.

Z.Rusmali: Ok, e qartë, përgjigja e pyetjes është që përveç kësaj që keni bërë nëpërmjet denoncimit ju nuk keni grumbulluar fakte, prova apo rrethana të tjera të tjera dhe pse se keni këtë detyrim.

Z.A.Kaziq: Realisht është e pamundur.

Z.Rusmali: Avokati i zotit Qalliu tha se fotot nuk tregojnë një aktivitet publik të deputetit, tregojnë vizita në shpi të banorëve të zonës, zgjedhësve të vet. Cili është qëndrimi juaj rreth këtij pretendimi, keni një analizë tuajën të ndryshme ose të kundërt në lidhje me këtë?

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

Z.A.Kaziaj: Patjetër që kam ,pikë së pari qendrimin e mbajtur nga kolegu avokat në këtë rast e përgënjeshton vetë vendimi numër 7 14.01.2021 i Komisionerit i cili e ka marrë nën përgjegjësi se përndyshe nuk do hynte në kategorinë e parashikimeve të nenit 2 që janë përkufizimet e vendimit numër 9 /2020 te Komisionit Rregullator, vetë komisioneri nuk duhet ta kishte marrë në përgjegjësi personin.

Z.Rusmali: Kjo është fiksofiste ,pala është kundër vendimit, ne nuk mund të kthejmë vendimin kundër pretendimit të saj.Qendrimi juaj...

Z.A.Kaziaj: Kjo është pikë së pari. Pikë së dyti unë e mbështes në këtë rast komisionerin pasi vëmpritaritë e ndaluara nuk kanë të bëjnë me veprimtari publike të marrjes së lejes por janë të ndaluara ligjërisht në pikën e dytë të vendimit numer 9 të Komisionit Rregullator.

Z.Rusmali:Pyetje tjetër nga kolegët ? Po, zoti Çefa.

Z.Çefa: Faleminderit. Avokat unë deshta me ditë nëse ju ,avokati i palës tjetër tha se nuk ishte në dijeni të faktit nëse subjekti I mbrojtur prej ti ka ndjekur këtë praktikë në mënyrë të vazhdueshme pra dërgimin e lejeve te legalizimit në banesë të subjektit. Pyetjen që kolegu im ja bëri avokatit unë po ja u bëj juve ,ju jeni në dijeni të ndonjë rasti tjetër që I njëjti drejtues i Kadastrës ka perdorur në menyrë të vazhdueshme ose jo këtë praktikë me perfituesit e lejeve të legalizimit?

Z.A.Kaziaj:Po, faleminderit zoti Çefa.

Ju keni material të themi administrative te depozituara në cilesinë e provës nga zoti Qalliu dhe nga sa kam lexuar nga vendimarrja ,vendimarrja e vendimit numër 7 e



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ,aty i kërkohet zotit Qalliu për peridha te caktuara sa leje janë dhënë ,se mesa shof vetëm 130 leje ishin dhënë për nëntorin e viti të shkuar ,pra besoj se ka pasur raste të tjera përderisa është ndjekur kjo praktikë ,por kjo nuk ligjeron rrugën ligjore që duhet të ndjeki praktika në vetvete ,pikë së pari .

Pikë së dyti Zoti Rusmali i beri dhe një pyetje kolegut avokat pak më parë për sa i përket pjesës të paktën nqs gaboj ,në qoftëse e citoj keq më korrigjoni,për sa i përket pjesës së vendimarrjes së drejtorit të ASHK Lushnje mbi dhënien e këtyre lejeve nga persona vartës të tij .

Pra do të thotë nqs këto leje janë dhënë siç relation drejtori nga specialist ose shefa sektori të cilët kanë shkuar në banesë por ndërkohë që ja paskan dhënë përpara deputetit dhe kjo është një praktikë joligjore, drejtori ka marrë ndonjë masë administrative kundrejt personelit të vet që ka nën mbikqyrje ose nën varësi , kjo është shumë e rëndësishme !

Z.Rusmali: Pyetje tjeter?

Z.Braho: Për përfaqësuesin e LSI – Atëherë një nga pretendimet që ju ngrini ka të bëjë me faktin e kualifikimit kundër vajtjes administrative qe sipas jush pretendoni që është e gabuar e ndjekur nga Komisioneri Shtetëror dhe duhet të jetë në zbatim të nenit 171 pika 1 të Kodit Zgjedhor, këtu normalisht nuk jemi në kushtet e anëtarëve të Komisionit te Zgjedhjeve, jemi në kushtet e pretendimit tuaj, një personi të ngarkuar me detyra sipas këtij kodi mund të na citoni cila është detyra e drejtorit te AKSH-së të Lushnjes ka sipas këtij kodi në këndvështrimin tuaj?



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

Z.A.Kaziq: Atëherë detyrat e subjekteve të këtij ligji përcaktohen në nenet 91 dhe 92 të kodit Zgjedhor dhe një funksionar i lartë i shtetit normalisht që ka detyra të mirëpërcaktuara dhe në vetë materian, lëndën e rregullimit të funksionit të vetë nëpërmjet ligjeve ose veprimeve përkatës duke pasur që kemi të bejmë dhe me ndalime në këtë rast të miratuara me kod dhe të shtrira në një hierarki administrative më të ulët të vendimit numër 9 të Komisionit Rregullator, nuk ka sesi mos të ketë ndalime ky funksion shtetëror i nderuar Zoti Braho.

Në këtë rast vendimi numër 9 parashikon të gjithë pjesën e zyrtarëve shtetëror të cilët (që është vendim i dalë në aplikim të Kodit Zgjedhor dhe nenit 91 dhe 92) me pozicione nuk mund të bejnë këto veprimtari absolutisht nga data 25 dhjetor që ka hyrë afati 4 muajor nga data e zgjedhjeve dhe në vijim. Këtu kemi një shkelje të qartë. Përveç faktit se dua të sjellë dhe në vëmendje të këtij komisjoni dhe pjesa e nenit 171/1 ,dhe pjesa e nenit 10/1 të vendimit numër 9/2020 të Komisionit Rregullator parashikon faktin kur nuk përbën veprë penale thotë togëfjalshi, në këtë rast mund të kemi dhe elemente të caktuar të nenit 248 të Kodit Penal ose 328/a të Kodit Penal dhe kjo duhet të ishte hetuar sic thashë nuk mundet nëpërmjet elementeve të caktuar të shpërdorimit të detyrës ose përdorimit të detyrës shtetërore për zgjedhje ose subjekte politike një përfaqësues i këtij shteti të bëj sikur e ka shpinë e vet dhe të diskriminojë disa qytetarë dhe avantazhojë disa të tjerë. Faleminderit!

Z.Rusmali: Po kthehemi tek pyetjet se më tërhoqi vëmendjen...

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

Z.I.Rusmali: Po kthehem unë tek pyetjet. Theksimi i faktit kur nuk përbën veprë penale. Në gjykimin tuaj, ka elementë të veprës penale tek ngjarja?

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Në gjykimin tonë kjo ngjarje ka elementë edhe të veprës penale i nderuar zoti Rusmaili. Për shkak se vetë procedura e ndjekjes së një rruge administrative ka ceduar duke u kthyer në një procedurë të privilegjuar. Privilegjuese me avantazhe. Pra cilat janë elementët e veprës penale të shpërdorimit të detyrës? Janë të qarta.

Z.I.Rusmali: Figura e krimit, shpërdorim detyre, në vlerësimin tuaj!

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Në vlerësimin tonë po, por ka elementë të nenit 328 a të Kodit Penal, i nderuar zoti Rusmaili!

Z.I.Rusmali: Dakord! Pyetje të tjera? Po!

Z.L.Braho: Shoh këto dokumentat bashkëlidhur që janë urdhërat të Agjensisë, të Drejtorisë Vendore të Kadastrës Lushnje. Shoh që pjesë e urdhrave janë me nr.protokolli normalisht protokollet dalëse të institucionit janë me fraksione më tej procesverbalet, ndërkohë që lejet e dorëzuara që janë të nënshkruara nga qytetarët që janë paisur me leje legalizimi, të paktën për tre praktikat që janë dërguar nuk kanë as protokoll hyrës të institucionit, as datë. Ka ndonjë sqarim në vazhdimësi të kësaj?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita Dulaku*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

Z.Ervin Zoto, përfaqëues ligjor i z.Arben Qalliu: Për cilin moment doni t'u sqarohet?

Z.L.Braho: Urdhërat janë me numrat e protokollit dalës, duke filluar nga urdhëri kryesor që është ky i datës 9.12.2020, më tej janë leje të dorëzuara në njësinë administrative ...

Z.Ervin Zoto, përfaqëues ligjor i z.Arben Qalliu: Janë me procesverbal në funksion të atij urdhëri prandaj janë ndarë në fraksione.

Z.L.Braho: Jo normalisht këto dokumente që janë ndarë nga specialisti dhe janë nënshkruar nga qytetarët në momentin që kanë marrë në dorëzim lejen e legalizimit sipas drejtorit të kadastrës, normalisht janë futur në protokoll hyrës në institucion.

Z.Ervin Zoto, përfaqëues ligjor i z.Arben Qalliu: Po po normal, në protokoll të tyre..

Z.L.Braho: Që të verifikojmë dhe .. sepse kjo do të ishte dhe mënyra për të verifikuar se kur janë marrë në dorëzim dhe ku është depozituar ky akt pranë Agjensisë së Kadastrës Lushnje. Ka ndonjë arsye pse këto janë pa protokoll hyrës dhe pa datë si dokument?

Z.Ervin Zoto, përfaqëues ligjor i z.Arben Qalliu: Pa protokoll hyrës?! Që janë kthyer në institucion.. Normalisht procesverbalet arkivohen, duhet të jenë në arkiv.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita Dulaku*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

Pra këto procesverbale nuk mund t'i gjejmë në vend tjetër përveçse në arkivën e institucionit..

Z.L.Braho: Më duket se nuk po më kuptoni? E kam për këtë dokument!

Z.Ervin Zoto, përfaqëues ligjor i z.Arben Qalliu: Është bashkëlidhur pra, është në funksion të saj!

Z.L.Braho: Aha është aneks i saj?

Z.Ervin Zoto, përfaqëues ligjor i z.Arben Qalliu: Po!


Z.I.Rusmali: A mundet nqs mund të bëj unë një pyetje shtesë meqenëse u kthyem këtu?ju thoni që lejet e legalizimit që janë shpërndarë që ne po merremi i përkasin periudhës nëntor, apo jo?!

Z.Ervin Zoto, përfaqëues ligjor i z.Arben Qalliu: Prodhimi po, kur janë lëshuar..

Z.I.Rusmali: Ndërkohë që provat shoqëruese me ankesën tuaj, ju na keni sjellë akte të dhjetorit. Lejet bashkëlidhur janë të nëntorit?

Z.Ervin Zoto, përfaqëues ligjor i z.Arben Qalliu: Po i nderuar, këto doja që të sqaroja më parë. Nuk duhet të ngatërrojmë lëshimin në funksion të prodhimit të atij dokumenti dhe dorëzimit, shpërndarjes. Pra prodhimi, ose lëshimi është bërë në muajin nëntor 2020, ndërsa shpërndarja është bërë në muajin dhjetor dhe në logjikë

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita Dulaku*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

ka filluar që në datën 9.12.2020 kur ka dalë dhe urdhëri për zbatimin e tij. Në qoftë se më lejoni të jap një sqarim në lidhje me pretendimet e kolegëve, ose në një moment tjetër?

Z.I.Rusmali: Jo mund t'i bëni tani.

Z.Ervin Zoto, përfaqëues ligjor i z.Arben Qalliu: Nuk jemi dakord me arsyetimin që ata përdorën në lidhje me provat, pasi që të bësh një denoncim duhet të kesh dhe prova. Nuk mundem unë tani që të bëj mijra denocime, të vë mijra njerëz në lëvizje që të gjejnë prova për të përdorur të kundërtën. Kjo është baza, kush denoncon duhet të ketë dhe prova për të provuar të kundërtën. Në lidhje me dorëzimin nga personeli i ASHK-ës. Të njëjtët punonjës do t'i dorëzojnë si në sportel si në banesë. Nuk është se në banesë e ka dorëzuar deputeti. Po të shohim dhe postimet e deputetit në asnjë moment nuk thuhet që po shp[ërndajmë leje. Thjesht kemi ardhur të shohim nga afër punën e tyre ndër vite. Pra, nuk thotë që po shpërndajmë leje. Në lidhje me datën, nuk provohet kurrësesi që këto janë bërë pas datës 25, pasi duket që janë postuar në një moment të vetëm. Pra, janë bërë në ditë të ndryshme, ose dhe në të njëjtën ditë në një datë të caktuar. Atë ditë dep[uteti e ka çmuar të arësyeshme t'i postojë. Pra, nuk është shkelje e Drejtorit të ASHK-së. edhe unë kam një leje legalizimi që mund t'ia jap një deputeti, apo kujtdo, t'i them hajde të bëjmë një foto. I bie tani që çdo drejtor ASHK-je të dënohet. Pse bën deputeti foto me një person që e ka të ndaluar se mund të jetë subjekt, pasi deputeti është subjekt. Nuk e di nëse... kam dhe diçka të fundit. Fraza "të dënohet qoftë dhe për shembull". Është parimi bazë, më mirë të lesh njëqind autorë të pandëshkuar se sa një të pafajshëm ta ndëshkosh, thjesht për një shembull.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita Dulaku*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

Z.I.Rusmali: Nejse, debat për formulimet e njëri-tjetrit nuk kemi pse të bëjmë. Duhet të bëjmë debat për provat jo për formulimin.

Z.Ervin Zoto, përfaqësues ligjor i z.Arben Qalliu: Pikërisht pra se s'ka prova. Unë me provat jam marrë, por...

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: I them kolegut avokat, për sa i përket pjesës së provave, flasim për një funksion të lartë shtetëror i cili në bazë të ligjit dhe Kodit të Procedurave Administrative ka detyrimin e provueshmërisë. Kështu që të gjitha provat duhet t'i sillte funksioni i lartë shtetëror.

Z.Ervin Zoto, përfaqësues ligjor i z.Arben Qalliu: Kam dhe një koment të fundit dhe nuk do të ndërhy më! Meqenëse kaluam përsëri tek provat. Kur u pyet konkretisht për fotot pasi pikërisht nga ato foto ata janë nisur, nuk është një provë e panjohur për ta. Nuk i dha sqarim, a janë ambjente të ndryshme, apo jo? Duket qartazi që janë ambjente të ndryshme, nuk kanë qenë të grumbulluar në një vend së bashku.

Z.I.Rusmali: Dakord, po u shpreh për këtë gjë.

Po, po ja ta theksoj unë si është shprehur, është shprehur jo në mënyrën e duhur, pasi ka marrë si referencë vendimin e Komisionerit. Po të ishte dakord me vendimin e Komisionerit...

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita Dulaku*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

Z.I. Rusmali: Ju jeni në pozicione të ndryshme nga njëritjetri. Nuk është e domosdoshme që të bini dakord me njëri tjetrin dhe nuk kemi nevojë të negociojmë as njëri nga ne, as ju, e as ne që ju të bini dakord me njëri-tjetrin. Ju i referoheni prapësimeve rreth provave që paraqesin njëra palë, apo pala tjetër ..

Z.Ervin Zoto, përfaqëues ligjor i z.Arben Qalliu: Po pra, nuk mund t'i referohet si provë vendimit kur ankohet.


Z.I.Rusmali:..dhe besoj që patët lirinë e mjaftueshme që t'i bënit këto prapësime.

Z.Ervin Zoto, përfaqëues ligjor i z.Arben Qalliu: Po, dakord i nderuar!

Z.I.Rusmali: Unë do t'u pyes nqs s'ka pyetje të tjera.. po zoti Braho!

Z.L.Braho: Një pyetje për avokatin e zotit Qalliu. Është e vërtetë që nga postimet në Facebook dhe unë atë dalloj që janë ambjente të ndryshme. Janë tre postime në facebook të deputetit Çela dhe janë disa foto tek secili postim. Tani ajo që unë kam të paqartë që më bën të dyshoj ka të bëjë me faktin se si ka mundësi gjithë këto familje në një hark kohor tre ditë postimesh në ambjente krejtësisht të ndryshme. Si është vënë në dijeni deputeti sipas jush në lidhje me këtë fakt. supozojmë rastin që certifikatat janë shpërndarë më parë nga specialistët e Kadastrës sipas urdhërit dhe procesvebaleve përkatëse dhe më tej i ka shkuar deputeti rastësisht që ka bërë gjithë fotografitë qofshin këto në ditë të ndryshme, pavarësisht datave. Kjo mënyrë kaq e organizuar ka ndonjë informacion nga ana juaj se si është kryer kjo procedurë në këtë mënyrë?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita Dulaku*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

Z.Ervin Zoto, përfaqëues ligjor i z.Arben Qalliu: Po i nderuar dhe të nderuar anëtarë, pikërisht fakti që këto postime janë shpërndarë në kohë, riprovojnë pretendimin tonë që mund të jenë bërë në data të mëparshme, pra ne nuk kemi të provuar ende nëse ato janë bërë në datën 25, apo jo? Pra, nëqdo të kishim të shpërndara nga vetë drejtori, sikurse të ishte dhe në foto, nëqdo ato foto nuk provohet se janë bërë nga data 25 e në vijim, brenda afatit 4-mujor nuk mund të jetë subjekt i këtyre normave ligjore. Pra, këtu është kufiri ndarës të nderuar, nuk provohet ende se kur janë bërë ato foto është e paprovuar. Por, vetë fakti që ka bërë foto në ambiente të ndryshme tregon përsëri që ka pasë kohëzgjatje. Në lidhje me informacionin me sa di unë ai është një nga deputetët aktiv dhe nuk është e vështirë për të marrë informacion në fshat apo në qytet. Edhe Tirana që është kryeqyteti i Shqipërisë që ka një numër shumë të lartë banorësh dhe përsëri është e mundur të marrësh informacion nëqoftëse ti kërkon. Janë në terren, janë të mirëllogaritur, deputetët për frymë për banorë dhe pretendohet që e kanë në kontroll zonën pra nuk është e vështirë për të marrë informacion. Sikurse edhe punonjësit e policisë që mund të marrin informacion.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita Dulaku*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Edhe një gjë të fundit zoti Rusmali, lidhur me pyetjen që bëri zoti Braho?

Z.I.Rusmali: Po patjetër.

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Vendimi i Komisionit Rregullator numër 9 në pjesën diku tek neni 3 besoj flet për promovim dhe mbështetje, në këtë rast kemi promovim të pastër dhe mbështetje të një veprimtarie të ndaluar. Kështuqë promovimi dhe mbështetja shihet qartë nga fotot e publikuara nga vetë deputeti. Fakti i pretenduar nga kolegu nuk qëndron absolutisht.

Z.I.Rusmali: Mirë, rikthehem në procedurë. Provat që ju keni janë ato që i keni bashkëngjitur të dyja palët kërkesave tuaja, ankimeve të paraqitura apo jo? Keni prova të tjera përveç këtyre?

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Provat janë ato, madje një pjesë e mirë e provave ndodhen edhe në dosjen e KQZ-së për shqyrtimin e ankimit të cilën ne e kemi kundërshtuar administrativisht në këtë rast.

Z.I.Rusmali: Ndonjë kërkesë për marje provash të reja?

Z.Ervin Zoto, përfaqësues ligjor i z.Arben Qalliu: Nuk kemi.

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Jo i nderuar, nuk kemi.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

Z.L.Braho: Për avokatin e zotit Qalliu, me dijeninë time kur kryhet procedura për aplikimin për leje legalizimi qytetarët paguajnë edhe një faturë për të marë praktikën nëpërmjet postës. Pastaj pavarësisht faktit që kanë pasur një urdhër që këto nuk do të shpërndareshin nëpërmjet postës por nëpërmjet specialistëve. A ka një praktikë të tillë për këto dokumentacione që ju keni sjellë këtu?

Z.Ervin Zoto, përfaqësues ligjor i z.Arben Qalliu: Po në dijeninë time kjo lloj pagese bëhej kur kanë qënë të ndara veç ZRPP-ja dhe veç Aluizni. Në këto momente nuk di që të ketë një praktikë të tillë që të paguajnë qytetarët për postën. Por për sa kohë edhe në nenin 154 shprehet me termin e dërgon me postë ose e dorëzon do të thotë që rëndësi ka qëllimi final që realizohet subjekti përfitues. Nëqoftëse do të kursejmë ato lekët e postës përsëri do të vijnë në dispozicion të institucionit që po i kursen ato para që në ratin konkret i bie që të jetë Drejtoria Vendore Lushnje dhe ASHK-së, faleminderit.

Z.I.Rusmali: Mirë, pyetje të tjera s'ka, çështje të tjera proceduriale s'ka, besoj se kemi arritur tek momenti i mbylljes së hetimit administrativ. Shumë shkurtimisht për secilin nga ju kush janë pretendimet përfundimtare që keni dhe mundësisht nga një fjali dhe shumë konkrete.

Z.Ervin Zoto, përfaqësues ligjor i z.Arben Qalliu: Po i nderuar, po e filloj unë shkurtimisht lidhet sikurse thashë nuk provohet që të jetë aktivitet publik pasi nuk ka pasur të pranishëm as persona të tjerë dhe as media, kanë qënë ambjente familjare. Në lidhje me këtë çdo veprim tjetër që mund të ketë ndodhur nuk është shkelje të Kodit Zgjedhor apo vendimit të Rregullatorit. Në foto sikurse thash data

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

nuk provohet se kur janë bërë pavarësisht se nga postimi duket që janë bërë pas datës 25, kjo nuk mund të provojë rrjedhimisht se kur janë bërë fotot. Pasi mund të jenë bërë në data të ndryshme dhe atë ditë e ka parë të arsyeshme deputeti ti postojë. Nëqoftëse do ta dënonim drejtorin për një rast të tillë ju garantoj unë se mund të bëhet praktikë kushdo që do të ketë mëri me një drejtor ose me drejtor institucionesh të tjera mund të dali me një kandidat apo me një deputet në një foto dhe ta postojë, pra nuk besoj që do të jetë një praktikë e tillë. Besoj që kaq sa është bërë publicitet për këtë rast është bërë sensibilizimi që nuk duhet të bëhen veprime të ndaluara. Por kjo nuk do të thotë që ne do ta dënojmë zotin Qalliu padrejtësisht. Të tjerat janë sikurse kam thënë por i kam edhe me shkrim dhe mund t'ua depozitoj në dosje, faleminderit.

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Pretendimi i faktit të mos hapjes së një precedenti të keq nga ana e përfaqësuesit të zotit Qalliu është deri diku, po bëjmë rolin e viktimës. Jemi qytetarë të këtij vendi nga momenti që ti kërkon si taksapagues qoftë edhe detyrimin të atij zotërisë që mban një post shtetëtor të paguar me taksat e tua për të bërë punën që i përcakton pozicioni qenka hapja e një tradite të keqe dhe të një precedenti të keq. Gjithësesi i nderuar zoti Relator, të nderuar anëtarë, për sa relatuam në mbështetje të nenit 30, pika 1, shkronja c, vendimi numër 3/2020 i kërkoj përfundimisht këtij Komisioni ndryshimin e vendimit numër 7 datë 14.01.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Z.Ervin Zoto, përfaqësues ligjor i z.Arben Qalliu: Mund ta plotësoj edhe unë? Dhe ne kërkojmë që të pranohet ankimi ynë duke hequr dënimin për zotin Qalliu.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

Z.I.Rusmali: Mund ta specifikoni njëçik më shumë kërkesën për ndryshim në ç'sens, në ç'kuptim, çfarë doni nga ne?

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Atëherë siç thash ndryshimin e vendimit numër 7 datë 14.01.2021 rregullimin e pasojave duke disponuar me ndryshimin e bazës ligjore në vendimmarrje parashikuar në nenin 171/1 dënimin maksimal administrativ të parashikuar në këtë nen dhe ne nenin 10 të vendimit numër 9 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator për t'i dhënë një shembull shqiptarëve që këtu organet e reja të ngritura me ligjin nr.101/2020 po marrin hapa drejt një procedure sa më korrekte dhe një procedure sa më transparente. Për të dhënë dhe një shembull për ato të cilët abuzojnë me detyrën, të cilët shpërdorojnë funksionin shtetëror, të cilët shpërdorojnë besimin e qytetarëve, të cilët shpërdorojnë taksat e taksapaguesve është qëllimi kryesor, faleminderit!

Z.I.Rusmali: Dënimin e deputetit, apo të drejtorit, apo të të dyve?

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Dënimin e të dyve të cilët edhe nga kjo seancë publike të sotme të Komisionit të Ankimeve dhe të Sanksioneve dolën elementë të provueshmërisë që lidhin shkak-pasojë të dyja qëndrimet e këtyre shtetarve njëri ligjvënës dhe tjetri përfaqësues i lartë i këtij shteti, të cilët në bashkpunim duke abuzuar me dispozitat ligjore përkatëse të cituara me sipër, kanë arritur qëllime për të hedhur poshtë parimin e barazisë të ardhme dhe duke i dhënë një subjekti politik të caktuar disa privilegje të pamërituara dhe për më keq të ndaluara.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 10:30*

Z.I.Rusmali: Mirë, unë ju falenderoj për pjesëmarrjen të dyja palët edhe për angazhimin e tyre në këtë seancë të KAS-it. Tani është momenti që ne të tërhiqemi për të marrë vendim. Ky është vendimi i parë që ne marrim dhe nuk jemi në gjëndje ende ta atarojme sa kohë do na duhet. Kështuqë do të keni durimin të prisni ose nëqoftëse zgjatet shumë ne do t'u njoftojmë nëpërmjet zyrës tonë të shtypit se si do të procedohet më tej, ose do ta merrni me shpallje, ose duke ju caktuar një orar për shpalljen. Paraprakisht prisni një gjysëm ore.

Z.A.Kaziqaj, përfaqësues i LSI-së: Patjetër, jemi në dispozicion!

Z.I.Rusmali: Faleminderit.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 13:15*

22.01.2021

Ora 13:15

Rifillon mbledhja e KAS

RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin e Kërkesës Ankimore nr.1 “Ndryshimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 7, datë 14.01.2021” me ankues, Lëvizja Socialiste për Integrim” dhe Kërkesës Ankimore nr.2 Ndryshimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 7, datë 14.01.2021” me ankues, z. Arben Qalliu, Titullar i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

PJESËMARRJA :

KQZ:

KAS:

Z.Elvin LAKO

Z.Elvis ÇEFA

Z.Ilirjan RUSMALI

Z.Koli BELE

Z.Ledio BRAHO

Stafi KQZ: Y.Merkaj, Olsi Peto

Parti politike: Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI

Z.Kreshnik Kolndreu, përfaqësues ligjor i LSI

Z.Ervin Zoto, përfaqësues ligjor i z.Arben Qalliu

Z.I.Rusmali: KAS-i u mbledh, shqyrtoi të gjitha provat e paraqitura nga palët. Shqyrtoi pretendimet e paraqitur, arësyet dhe argumentat që kanë shoqëruar ato dhe kamarrë vendimin e tij. Vendimin ju do ta gjeni të zbardhur pak më vonë të

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita Dulaku*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 13:15*

plotë me të gjithë arsyetimin e tij. Unë po përpiqem të jap shkurtimisht dispozitivin e këtij vendimi dhe disa nga arësyet kryesore ku ne jemi mbështetur në vendimmarrjen tonë. Ky vendim është marrë me shumicë votash. KAS ka vendosur:

1. Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.7, datë 14.01.2021.
2. Pranimin e ankimit të z. Arben Qalliu lidhur me gjobën;
3. Rrëzimin e ankimit të Lëvizjes Socialiste për Integrim për dënimin administrativ të deputetit Bujar Çela;

Si dhe ka vendosur:

4. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve të informojë Agjensinë Shtetërore të Kadastrës dhe t'i kërkojë që, në respektim të standartit të zgjedhjeve dhe neutralitetit të administratës publike, deputetët, deri në datën e zgjedhjeve të mos ftohen prej atij institucioni në veprimtaritë rutinë të administratës qendrore dhe vendore të tij, të cilat zhvillohen në kontak e në komunikim dhe bashkëpunim me zgjedhësit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Tani pak fjalë për arsyetimin e tij se ndoshta kanë dhe interes. Cilat kanë qenë konstatimet tona në rradhë të parë konstatimi i parë ka qenë se

Vendimi nr.9, datë 24.12.2020 i Rregullatorit disiplinon veprimtarinë e ekzekutivit dhe të administratës publike në varësi të tij. Veprimi i tij është i kufizuar në kohë dhe përfshin kryesisht periudhën 4 muaj para datës së

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita Dulaku*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 13:15*

zgjedhjeve, deri në datën e zgjedhjeve. Vendimi përcakton detyrimin për transparencë, vetpërmbytje dhe kufizim për ekzekutivin dhe administratën publike, me qëllim që ata t'i ushtrojnë funksionet e veta publike me neutralitet ndaj garës zgjedhore. Ky është qëllimi i atij vendimi. Bile aty thuhet po citoj “ Gara zgjedhore duhet të zhvillohet në kushte të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe fondet dhe burimet publike të mos përdoren për qëllime partiake”. Ky vendim përcakton një listë me veprimtari të ndaluara për t'u promovuar dhe me veprimtari të ndaluara për t'u zhvilluar. Në rrethin e veprimtarive të ndaluara për t'u zhvilluar bën pjesë “shpërndarja në veprimtari publike e lejeve të legalizimeve, në periudhën katër mujore para datës së zgjedhjeve “. Shpërndarja e lejeve të legalizimit është veprimtari rutinë e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, e cila nuk ndërpritet për shkak të periudhës zgjedhore. Ajo që vendimi ndalon është kryerja e saj përgjatë veprimtarive publike. Veprimtari publike, në kuptimin e pikës 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor dhe referuar në Vendimin nr.9, datë 24.12.2020 të Rregullatorit është vetëm veprimtaria që është e hapur për pjesmarrjen e publikut dhe të medias, si dhe ajo që ka në agjendë informimin e publikut rreth saj. Kjo është e rëndësishme për t'u mbajtur në konsideratë. Nga shqyrtimi i provave në dosje nuk rezulton e provuar se deputeti Bujar Çela të ketë ushtruar funksione që i përkasin Drejtorisë Vendore të ASHK-së, Lushnje, as që të ketë dubluar punonjësit e saj gjatë ushtrimit të detyrës. Në rastin në shqyrtim, rezulton e provuar se deputeti

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita Dulaku*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 13:15*

Bujar Çela ka pozuar me banorë të paidentifikuar të Njësisë Administrative Hysgjokaj, sipas deklarimeve të veta dhe të denoncuesit, me certifikatat e lejeve të legalizimeve në duar, në mjediset e brendshme të banesave, në oborret ose në hyrjet e tyre. Rrethanat e rastit nuk provojnë shpërndarjen e certifikatave nga deputeti, por krijojnë bindjen, se ai ka marrë pjesë në proces. Nga ana tjetër, nuk rezulton e provuar që kryerja e veprimtarisë të jetë bërë në vende të hapura për publikun, në sheshe ose në njësitë e shërbimeve komunitare të zonës, apo që publiku të jetë ftuar në çfarëdo lloj forme për të marrë pjesë në veprimtari, apo media të ketë shoqëruar deputetin apo të ketë raportuar për ndonjerën nga këto veprimtari. Barra për kualifikimin e shkeljes, në rastin konkret për karakterin publik të veprimtarisë, i ka takuar ankuesit LSI që në momentin e depozitimit të raportimit. Psh ankuesi duhet të ndante paraprakisht bëse jemi përpara kryerjes së një vepre penale, siç u diskutua dhe këtu, apo përpara një shkelje administrative, përpara se të zgjidhte rrugën ligjore që zgjodhi. Pra ky arsyetim duhet të bëhej nga ankuesit në momentin që ata vunë në lëvizje procesin, sepse është element kryesor, kusht për ekzistencën e shkeljes ose jo. Faktet e mësipërme provojnë se veprimtarisë së denoncuar i ka munguar karakteri publik, atë që parashtruar më sipër. Karakteri publik është kushti që ndan lejimin nga ndalimi i veprimtarisë. Për këtë arsye, çdo referencë tek shkronja "a" e pikës 1.3 të nenit 3 të vendimit nr.9, të Rregullatorit është e pavend dhe nuk ndihmon gjykimin e çështjes. Për më tepër, pretendimi i ankuesit LSI, se KQZ-ja duhet të dënojë shkelësit në bazë të pikës 1 ose pikës 2 të nenit 10 të vendimit nr.9 të Rregullatorit, gjithashtu nuk ka lidhje me rastin në fjalë. Sanksionet e referuara nga ankuesi LSI i takojnë rastit kur ka pasur veprimtari publike të raportuara dhe KQZ-ja ka ndërhyrë për ndalimin e tyre,

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita Dulaku*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 13:15*

nëpërmjet vendosjes së shënimit në ndërfaqen e veprimtarive “Ndaluar nga KQZ-ja” dhe kur veprimtaritë janë kryer gjithësesi. Në rast se ka ndodhur kjo shkelje veprojnë sanksionet e kërkuara nga ankuesi LSI dhe jo në raste të tjera. Ne u ndalëm gjatë në një arësyetim tjetër që ne e konsiderojmë të rëndësishëm për çështjen dhe çështjet që mund të vijnë në vijim. Në arësyetimin se pavarësisht veprimtaria nuk ka qenë publike dhe për këtë shkak nuk mund të dënohej nga KQZ-ja, për shkak se i mungonte publiciteti. Jemi përpara ndonjë veprimtarie e cila gjithësesi vjen në kundërstim me standartt tona të zgjedhjeve? Standarte që kërkon kodi aktual dhe që kërkon vendimi nr.9 i Rregulltorit. Ne gjykojmë që është gjykim standarti gjykimi që e konsideron praninë apo aktivizimin e deputetit në veprimtarinë e administratës publike si veprim që i jep me ose pa dashje ngarkesë politike punës rutinë të administratës. Në veprimtari të tilla si shpërndarja e lejeve të legalizimit, administrata është brenda rrethit të detyrave të veta të ligjshme. Zbatimi i detyrës nuk është meritë për administratën, është korrektesë ligjore. Prania e deputetit e bën atë të perceptohet vetiu si meritë, si avantazh, si aftësi e posaçme, e cila ka lidhje vetëm me përkatësinë politike. Një përpjekje për të transformuar perceptimin e njerëzve në formën e pranisë, pjesmarrjes apo angazhimit bashkë me administratën publike në kontaktin e saj me njerëzit, katër muaj para zgjedhjeve, është e rëndësishme periudha, edhe pse nuk ndalohet shprehimisht nga Kodi Zgjedhor, sepse nuk është veprimtari publike, bie ndesh me standartin e zgjedhjeve që kërkon ky Kod dhe me parimin e neutralitetit që thashë në ndërhyrjen time të parë, më sipër. I takon Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe grupeve parlamentare që të kujdesen, me qëllim

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita Dulaku*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.01.2021, ora 13:15*

që deputetët të respektojnë këtë standart dhe neutralitetin e administratës publike, deri në datën e zgjedhjeve, duke ushtruar vetkufizim ndaj veprimtarisë rutinë të administratës publike, kur ajo zhvillohet nëpërmjet kontaktit, komunikimit dhe bashkëpunimit me zgjedhësit. Standarti i zgjedhjeve e kërkon që përdorimi i burimeve publike dhe zbatimi i detyrave nga administrata publike të trajtohen si të mira publike që i përkasin shoqërisë dhe që nuk bartin as përcjellin ngarkesa politike. Ky standart i kërkon Drejtorit të Drejtorisë Vendore të ASHK-së, Lushnje, që të mos lejojë në asnjë rrethanë përdorimin politik të detyrës dhe të stafit të tij. I njëjti standart kërkon që organi i tij epror të marrë masa që resurset dhe procedurat e veta administrative të mos shfrytëzohen për përfitime të padrejta politike. Prandaj ne jemi nisur dhe kemi bërë këtë arsyetim ndonëse nuk vendosim dot masa dënuese për shkak se veprimtaria nuk ka qenë publike. Ashtu siç e kërkon Kodi dhe e ka të përkufizuar çfarë quhet veprimtari publike. Pavarësisht nga kjo veprimtaria edhe pse nuk është e dënueshme bie në konflikt me standartin tonë të zgjedhjeve edhe për këto arsye, sepse cënon parimin e neutralitetit të administratës dhe prandaj ne i kemi kërkuar në rastin konkret Agjensisë Shtetërore të Kadastrës që të mbajë qëndrim aktiv dhe të marrë masa që veprime të tilla të mos përsëriten më në të ardhmen. Ky ka qenë arsyetimi ynë në thelb në mënyrë të detajuar dhe të hollësishëm do ta merrni sapo ai të zbardhet. Këtu e mbyllim shqyrtimin e kësaj çështje, duke ju falenderuar të gjithëve për pjesëmarrjen.

Vendimi nr.4

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita Dulaku*

